

Tiranë, më 7 Prill 2022

KËRKESË PËR OFERTË

SUBJEKT TREGTAR PËR REALIZIMIN E MARKIMIT/BRANDIMIT TË NJË AUTOMJETI

Në kuadër të zbatimit të projektit “Për mbështetjen e Kuvendit dhe Edukimit Qytetar (PACEP)”, me mbështetjen financiare të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është duke planifikuar realizimin e 18 (tetëmbëdhjetë) ditëve të hapura, të cilat do të shtrihen përgjatë muajve Prill-Qershor 2022 (në varësi të planifikimeve të realizuara nga ana e stafit zbatues të projektit). Për realizimin e këtij turi në qytete të ndryshme të Shqipërisë, KShH ka kontraktuar një automjet me qera (i përshtatshëm për 7-9 persona).

Në kuadër të planifikimit të këtij turi, KShH shpall thirrjen publike për përzgjedhjen e një subjekti tregtar, i cili mund të realizojë markimin/brandimin me logo dhe thënie (brandimin) e automjetit (të llojit minibus), me qëllim reklamimin e iniciativës së ndërmarrë nga KShH dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve me motot e iniciativës.

Logot të cilat do të vendosen janë në total 5 (përvec logove të vendosura në header dhe footer të kësaj kërkesë) është edhe logo më poshtë:



Ndërsa thëniet motivuese që do të pasqyrohen në anë të ndryshme të automjetit janë: “Bëje për vete!” dhe “Zëri yt është i rëndësishëm”

Oferta financiare duhet të përfshijë:

- Ofertën financiare për markimin e automjetit (në monedhën Lekë, me TVSH të përfshirë). Në rast se subjekti është i përjashtuar nga TVSH, duhet që ta deklarojë këtë status në kërkesën e tij për ofertë.
- Kohën e lëvrimit të shërbimit të markimit/brandimit të automjetit

Projekti i :

Zbatuar nga:



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



- Ofertën financiare për heqjen e markimit/brandimit nga automjeti dhe kohën në dispozicion që duhet të respektojmë për heqjen e markimit/brandimit të automjetit
-

KShH fton të gjitha subjektet e interesuara që të dërgojnë në formë elektronike në adresën e e-mailit të KShH-së office@ahc.org.al, deri në datën 15.04.2022, dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1. Ofertën financiare në Euro (me TVSH të përfshirë ose me deklaratën mbi statusin për përjashtimin nga TVSH)¹**
- 2. Foto të punimeve të mëparshme (attach me foto)**
- 3. Çertifikatën e regjistrimit të subjektit tregtar**

¹ Subjektet që nuk disponojnë kete status, duhet te deklarojne ne oferten e tyre mbi TVSH-ne.

Projekti i :

Zbatuar nga:

